

SYLLABUS I LËNDËS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Edukimi mjedisor
Niveli:	BSc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Gr. 1. E marte 08:45-10:15 Salla P2 Gr. 2 E marte 10:30-12:00 Salla P2
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. asc. Dr. Zeqir Veselaj, Asistent; Msc. Zenel Krasniqi
Detajet kontaktuese:	Tel. 038 229021 E mail: Zeqir.veselaj@uni-pr.edu ze.krasniqi@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Kursi është ka qëllim kryesor që të pajisë studentin-mësimdhënë të ardhshëm me njohuritë e nevojshme shkencore mbi mjedisin, raportin e njeriut dhe qenieve të gjalla me të dhe rolin e edukimit dhe vetëdijësimit për ruajtjen e mjedisit.
Qëllimet e lëndës:	Me kursin studentët do të fitojnë njohuritë bazë bashkëkohore shkencore mbi: - biosferën si tërësi ku zhvillohet jeta, funksionimin, organizimin dhe proceset kryesore që ndodhin në të, - mjedisin dhe edukimin mjedisor: historiku dhe parimet, - konceptet mjedisore si ndotja, ndotësi, pasojat e ndotjes; edukimin mbi mjedisin dhe komponentet e tij: uji, ajri, toka dhe biodiversiteti; - aktivitetet kryesore zhvillimore të njeriut me ndikim në mjedisin jetësor, - edukimin mbi presionet në mjedis dhe problemet globale mjedisore; - mjedisin e vendit dhe problemet kryesore, masat ligjore dhe edukative, - edukimin mjedisor dhe për zhvillimin e qëndrueshëm.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas kompletimit të kursit studenti do të jetë në gjendje: - të kuptoj konceptet kryesore të bioferës dhe mjedisit: mjedisi, ndotja, ndotësit, burimet, zhvillimi i qëndrueshëm etj. - të diferencoj komponentet kryesore mjedisore (ujë, ajër, tokë dhe biodiversiteti) me kompleksitetin dhe ndërvarësinë e tyre nga njëër-tjetri; - të identifikoj dhe vlerësoj ndikimet dhe presionet kryesore në mjedisin jetësor ku jetojmë, - të njeh dhe interpretoj sfidat globale mjedisore si: ngrohja globale dhe

	<p>ndryshimet klimatike, hollimin e ozonit, acidifikimin, ndotjen e oqeanit botëror etj.,</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktoj mekanizmat kryesor globalë, evropian dhe nacional për mbrojtjen e mjedisit dhe edukimin mjedisor, - të aplikoj metodat, teknikat, materialet, metodat e vlerësimit për edukimin mjedisor në botë dhe në Kosovë, - të analizoj mjedisin lokal ku jeton dhe problemet e tij.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	
Aktiviteti	Orë Ditë/javë Gjithsejt
Ligjërata	2 13 26
Ushtrime teorike/laboratorike	1 15 15
Punë praktike	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1 15 15
Ushtrime në teren	
Kollokfiime, seminare	2 2 4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë/shtëpi)	2 15 30
Përgaditja përfundimtare për provim	1 15 15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3 2 6
Projektet, prezentimet, portfolio etj	1 15 15
Totali	
	121
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata bashkë-biseduese, përcjellë me prezantime problemore të problemeve mjedisore, simulime të studimeve të rastit, dhe punën praktike në klasë e në terren. Vizitë me student në një nga pikat e ndotjes dhe në një nga zonat e mbrojtura natyrore të Kosovës.
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësim është formativ ku përfshihen këto faza të vlerësimit:</p> <p>Vlerësimi i parë intermedier: 15%</p> <p>Vlerësimi i dytë intermedier: 15%</p> <p>Vlerësimi nga pjesa praktike: 10%</p> <p>Portfolio e studentit 5%</p> <p>Puna seminarike/projekti 5%</p> <p>Testi final: 50%</p> <p>Total: 100%</p> <p style="text-align: right;"><u>Pikët (%) Nota</u></p> <p style="text-align: right;">95 -100 10</p> <p style="text-align: right;">85 - 94 9</p> <p style="text-align: right;">75 - 84 8</p> <p style="text-align: right;">65 - 74 7</p> <p style="text-align: right;">55 – 64 6</p> <p>Sqarim: Vlerësimet intermediere- Vlerësimi i parë intermedier mbahet pas</p>

	<p>javës së 5 të ligjëratave. Vlerësimi i dytë intermedier mbahet pas javës së 10 të ligjëratave. Nëse studenti humb dy (2) vlerësimet intermediere dhe pjesën praktike e humb të drejtën e hyrjes në provim për vitin akademik përkatës.</p> <p><i>Pjesa praktike-</i> është pjesa e punës praktike që kryen student gjatë orës së ushtrimeve dhe vlerësohet nga asistenti i lëndës.</p> <p><i>Detyra seminarike</i> në formë projekti dorëzohet në fund të semestrit për vlerësim nga mësuesi i lëndës. Pjesa praktike e provimit është pjesë e vlerësimit final (me pikë) dhe parakusht që studenti t'i nënshtrohet provimit teorik të mësuesit të lëndës.</p> <p><i>Portfolio e studentit-</i> përfshin materialet e kursit të studentit në dosje: ligjëratat, prezantimet Power Point, fletoren e punës në ligjëratë, fletoren e punës së pjesës praktike, punët seminarike e individuale dhe çdo elemente tjetër të realizuar nga studenti në realizimin e kursit.</p> <p>Pikët nga pjesa formative e vlerësimit (vlerësimet intermediere, projekti dhe praktika) vlejné vetëm brenda tri (3) afateve të provimit.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	- Veselaj Z.: Njeriu dhe mjedisi jetësor, Dispencë me ligjëratat të zgjedhura.
Literatura shtesë:	<p>- Ramadani I. (2011) "Mjedisi jetësor roli i njeriut, sfidat dhe perspektiva", SHB Vatra, Prishtinë</p> <p>- Grup autorësh (2010) "Paketa e Gjellbër" për Kosovën, REC Zyra në Kosovë</p> <p>- Dollma M. (2013), "Ekologjia humane" SHB Marin Barleti, Tiranë</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Tokat si ekosisteme: biosfera dhe ekologjia. Konceptet e organizimit të biosferës, proceset kryesore të qarkullimit të materies dhe energjisë në ekosistem. Ekologjia si shkencë dhe mjedisi jetësor
Java e dytë:	Mjedisi jetësor dhe ndotja e tij. Ndotja dhe ndotësit. Faktorët e ndotjes globale. Lirimi i ndotësve në mjedis, futja e tyre në organizëm, shpërndarja dhe pasojat e tyre për shëndetin.
Java e tretë:	Përbërësit e mjedisit- Atmosfera. Ajri, përbërja e tij natyrore. Ndotja dhe ndotësit primar dhe sekondar të ajrit. Burimet e ndotjes së ajrit të jashtëm dhe të brendshëm. Pasojat e ndotjes së ajrit dhe sëmundjet. Masat edukative për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.
Java e katërt:	Përbërësit e mjedisit- Hidrosfera. Uji- substancë e jetës. Ndotja fizike, kimike dhe biologjike e ujit dhe ndotësit. Ujrate zeza dhe trajtimi i tyre. Pasojat e ndotjes së ujit dhe sëmundjet. Masat edukative për kursimin dhe ruajtjen e ujit nga ndotja.

Java e pestë:	Përbërsit e mjedisit- Litosfera. Dheu dhe përbërja e tij. Funksionet kryesore. Degradimi dhe ndotja e tokës. Pasojat e ndotjes dhe degradimit. Masat educative për ruajtjen e tokës nga degradimi dhe ndotja.
Java e gjashtë:	Testi i parë intermedier
Java e shtatë:	Përbërsit e mjedisit- Biodiversiteti. Konceptet kryesore dhe nivelet e organizimit të biodiversitetit. Dobitë dhe përfitimet nga biodiversiteti. Varfërimi i biodiversitetit dhe faktorët. Zonat e mbrojtura natyrore. Edukimi dhe natyra, të mësuarit në natyrë.
Java e tetë:	Mjedisi dhe sfidat globale për njerzimin: Efekti serrë, ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike. Varfërimi i shtresës së ozonit. Acidifikimi dhe shirat acidike. Ndotja e oqeanit botëror. Masat educative për mbrojtjen nga sfidat globale.
Java e nëntë:	Presionet kryesore mbi mjedisin: Mbeturinat- gjenerimi dhe administrimi. Kimikatet dhe kimizimi i jetës moderne. Urbanizmi dhe njeriu. Zhurma dhe jeta jonë. Masat educative për mbrojtjen nga mbeturinat, kimikatet, dhe zhurma.
Java e dhjetë:	Mjedisi dhe sektorët zhvillimor me ndikim në mjedis: Energjetika, industria dhe transporti, bujqësia, pylltaria dhe turizmi.
Java e njëmbëdhjetë:	Testi i dytë intermedier
Java e dymbëdhjetë:	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe kufiri i qëndrueshmërisë së planetit. Gjurma ekologjike, e karbonit dhe e ujit. Dita e tejkalimit të Tokës. Edukimi mbi ndikimin individual në mjedis.
Java e trembëdhjetë:	Edukimi mjedisor: historiku dhe zhvillimet kryesore sot në botë. Edukimi për, mbi dhe në mjedisin jetësor.
Java e katërbëdhjetë:	Edukimi mjedisor: strategjitë, metodologjitë, burimet dhe vlerësimet.
Java e pesëmbëdhjetë:	Edukimi mjedisor në Konizën Kurrikulare të Kosovës: përfshirja, resurset dhe metodologjitë. Paketa e Gjellbër në shkollat e Kosovës

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime është i obliguar dhe kushtezohet me nenshkrim. Nëse humben 30% e ligjëratave pa ndonje arsye të qëndrueshme, studenti e humb të drejtën e hyrjes në provim sipas dispozitave të Statutit të UP. Rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në procesin mësimor, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.